



SYN.0187

SYNTech HAG ECO

Rrëshirë poliuretani
hidroekspansive, pa tretës, e
injektueshme

Kodi doganor

3909 5090

Amballazhimi

- Kanoçe 25 kg [A]
- Bidon 2.3 kg [B]
- Kit: 1 Kanoçe 25 kg [A] + 1 Bidon 2.3 kg [B]

Aplikimi

- Injeksion
- Pompë

Familja
Syntech

Linjat e produkteve

- **Aqua**
- **Infratech**

Tipologja

Rrëshirë poliuretani hidroekspansive dhe artikuj të ngjashëm

Kategoritë e përdorimit

- Ndalim i menjëhershëm i depërtimit të ujit me presion në ndërtesa
- Hidroizolim i ambjenteve nëntokësore me produkte hidroekspansive
- Hidroizolim i nyjeve të lëvizjes ose nyjeve të ndërtimit
- Ndërhyrje strukturore mirëmbajtjeje për diga, vaska, ujësjellësa dhe kanalizime hidrike
- Ndërhyrje strukturore mirëmbajtjeje të tuneleve dhe galerive

Përbërësit
Bikomponent

Paraqitja

I lëngshëm + I lëngshëm

Certifikimi dhe rregulloret



D.M. 06/04/2004, n. 174

Rregullore në lidhje me materialet dhe objektet që mund të përdoren në sistemet fiksë të mbledhjes, trajtimit, mbledhjes dhe shpërndarjes së ujit të destinuar për konsum njerëzor (në zbatim të Direktivës 98/83/CE).

Përshkrimi i produktit

Rrëshirë poliuretani me një përbërës, aktivizuar për kontakt me ujin e pijshëm, gjysmelastike, që zgjerohet (rrit volumin fillestar rrëth 20 herë), i përsosur për bllokimin me injektim të rrjedhjeve të vogla dhe të mëdha të ujit në beton ose në mure të ngurta në përgjithësi. E përsosur për mbushjen e boshllëqeve të mëdha dhe hapësirat e themelive të lirshme të gurit brenda mureve.

Të dhëna shtesë

SYNTech HAG ECO kur bie në kontakt me ujin, formon një shkumë poliuretani gjysmëfleksibël. Teknikisht do të ishte një produkt monokomponent që reagon në mënyrë spontane me lagështirën e pranishme në muret që do të izolohen. Megjithatë, shpejtësia e reaksionit vetëm me ujin, mund të jetë e ngadalshme për nevojat e kantierit. Prandaj, éshëtë e domosdoshme të përdoret një përshpejtues zgjerimi, i cili shitet bashkë me rrëshirën (përbërësi B).

Shkuma e poliuretanit që do të formohet pas injektimit, sapo të zgjerohet, do të ketë volum të qëndrueshëm. Një rezistencë e mirë ndaj presionit të ujit, ndodh pas rrëth 1-2 minutash nga momenti i reaksionit. Formimi i CO₂, tipik i reagimit të poliuretanit, do të sigurojë presion të mëtejshëm në sistem, duke favorizuar depërtimin e rrëshirës në çarje dhe nëpër zgavra. SYNTech HAG ECO, në një mëdusë pa kufizime hapësire, zgjerohet rrëth 20 herë në krahasim me volumin e tij fillestar.

Konsumi

Konsumi i produktit varet nga madhësia e vëllimit të vakumit që duhet të plotësohet dhe në reagimin e shtrirë që ndodh pas përzierjes së dy komponentëve në raport me sasinë e ujit të pranishëm.

Fushat e përdorimit

Ndaloni depërtimin e ujit në hapësirat nëntokësore. I përsosur për hidroizolimin nëpërmjet mbushjes të zgavrave të mëdha ose të themelive të gurta të lirshme në muret me beton dhe në muret e ngurta në përgjithësi.

IF YOU WANT TO SOLVE IT
azichem

www.azichem.com

Përditësimi më: **05/08/2021**

Kushtet e shitjes dhe parashikimet
ligjore mund të lexohen në
www.azichem.it/disclaimer

Vetitë kryesore

	Produkt në dukje		Jetëgjatësia: 6 muaj
	Pa tretës		Pesha specifike: 1.15 kg/dm³
	Pot life: <5 min		Produkt hidroekspansiv: +2000 %
	Të përdoret me doreza mbrojtëse		Të përdoret me syze mbrojtëse
	Temperatura e aplikimit: +8 / +35 °C		Ngjyrat në dispozicion Qelibar

Veçoritë teknike

Viskoziteti: 90 mPa

Mjetet e pastrimit

- Diluent Nitro

Shtresat e lejuara

- Beton
- Tulla
- Shtuf
- Muratura të përziera
- Muratura me gurë
- Faqe shkëmbore

Përgatitja e shtresave (mbështetëse)

Shtresat mbështetëse ku do të aplikohet produkti duhet të jenë të pastra, pa kore, pjesë të shkatërruara që nuk ngjiten, pluhur, myshk, myk etj. Bëni gati injektorët që do ju duhen të përdoren hap pas hapi (nga njëra anë e hapësirës që do të mbyllët në tjetrën). Paraprakisht futni ujë të bollshëm në hapësirë, deri sa të ngopet (nëse nuk rezulton e tillë).

Mënyra e përdorimit

Derdhni në një kovë 100 g nga përbërësi B për çdo kilogram përbërës A. Përziejini mire të dy komponentët me një vegël dore. (Mos përdorni mikser elektronik)

Kini parasysh se rrëshira mund të reagojë edhe me lagështinë e mjedisit, prandaj, për të zvogëluar humbjet e materialit, eshtë e këshillueshme që të përgatitet përzierje veç aq sa eshtë e nevojshme për përdorim (2-3 kg përzierje në një mund të jetë më se e mjafqueshme). Përzierja e SYNTech H.A.G. ECO dhe katalizatori i saj mund të injektohen me pompa manuale ose elektrike të përshtatshme për rrëshira me një përbërës, me shtypje që luhatet midis 40 dhe 200 bar.

Shpejtësia e reaksionit mund të rregullohet lehtësisht në bazë të sasisë së përshpejtuesit (përbërësit B). Përdorimi i një sasie më të madhe katalizatori, p.sh. edhe 10% e sasë së rekomanduar, zvogëlon kohën e reaksionit.

Gjithmonë, pasi të mbaroni punë, pastrojeni tërësisht pompën e përdorur me hollues Nitro dhe me pastruesin vajor të posaçëm SYNTech H.A.G. CLEANER.

Magazinimi e Ruajtja

Ruhet nga ngrica. Ruajeni produktin në amballazhimin origjinal, në një mjedis të freskët dhe të thatë, duke shmangur acarin dhe rrezet e drejtpërdrejta të diellit. Ruajtja e papërshtatshme e produktit mund të shkaktojë humbje të veteve reologjike. Qeset e hapura duhet të përdoren menjëherë. Mbrojeni nga lagështia. Ruajeni produktin në një temperaturë nga +10°C në +30°C.



www.azichem.com

Përditësimi më: 05/08/2021
Kushtet e shitjes dhe parashikimet
ligjore mund të lexohen në
www.azichem.it/disclaimer



Paralajmérime, Masa paraprake, Ekologji

Të dhënat e përgjithshme, ashtu si dhe indikacionet dhe sugjerimet për përdorimin e këtij produkti, të paraqitura në këtë fletë teknike të të dhënave dhe mundësishët të shpjeguara dhe me gojë ose me shkrim, përpunten me gjendjen aktuale të njofurive tona shkencore dhe praktike.

Të dhënat teknike dhe të performancës të paraqitura janë rezultat i provave laboratorike të kryera në një mjeshtëri kontrolluar dhe si të tillë mund të ndryshojnë në lidhje me kushtet e vëni të funksionimit.

Azichem Srl nuk merr asnjë përgjegjësi që rrjedhin nga performanca jo e duhur që ka lidhje me përdorimin jashtë rregullave të produktit, ose që ka lidhje me defektet që rrjedhin nga faktorë ose elementë që nuk kanë lidhje me cilësinë e produktit, duke përfshirë këtu dhe konservimin e pasaktë.

Kushdo që synon të përdorë produktin duhet të vendosë, para përdorimit, nëse është i përshtatshëm për përdorimin e synuar, duke marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë e tij.

Karakteristikat teknike dhe të performancës të përfshira në këtë fletë të dhëna teknike përditësohen në mënyrë periodike. Për një konsultë në kohë reale lidhuni me sitin: www.azichem.com. Data e rishikimit paraqitet në cep të produktit. Ky njoftim anulon dhe zëvendëson çdo njoftim tjeter të mëparshëm.

Mos harroni se përdoruesi është i detyruar të lexojë Fletën më të fundit të të Dhënave të Sigurisë së këtij produkti, që përmban të dhëna kimike-fizike dhe toksikologjike, parashikimet e rrezikut dhe informacione të tjera me qëllim që të transportojë, përdorë dhe asgjësojë produktin dhe paketimin e tij me siguri të plotë. Për konsultim lidhuni me sitin: www.azichem.com.

Ndalohet hedhja e produktit dhe / ose amballazhit të tij në mjeshtëri.

SYNTECH HAG ECO është fiziologjikisht i padëmshëm pasi të ketë ndodhur reagimi. Produkti është paketuar me azot të thatë dhe është shumë i ndjeshëm ndaj lagështisë, duke përfshirë atë të mjeshtëri. Është e këshillueshme që të përdorni një sasi të vogël dhe pastaj ta mbyllni me kujdes kutinë.

Sigurohuni që injektorët të vendosen mirë aty ku do të ripërdoren. Duke pasur parasysh presionin e lartë me të cilin injekton pompa, në rast të mospozionimit të qëndrueshëm dhe të saktë, ekziston një rrezik real që përbërja të mund të dalë me shpejtësi të lartë jashtë vendit të përcaktuar (duke rrezikuar të lëndoje punonjësit!).

Studioni me kujdes pozicionimin e injektorëve, kur bëhet fjalë për shkëputje të mureve.

Pozicionimi i keq, shumë i afërt me hendekun që duhet mbushur, nën presionin e pompës mund të shkaktojë thyerjen e vetë bazamentit.

Bëni kujdes gjatë përdorimit të pompave elektrike, të cilat lehtësishët mund të arrijnë presionin 200 bar, dhe për këtë arsyë të shkaktojë thyerje të padëshiruara të sipërfaqeve të betonit dhe të mureve ku do futet përbërja.

Hiqni mbetjet e rrëshirës nga muret brenda disa orëve nga përdorimi. Heqja me vonesë mund të jetë më e vështirë.

IF YOU WANT TO SOLVE IT
azichem

www.azichem.com

Përditësimi më: 05/08/2021

Kushtet e shitjes dhe parashikimet ligjore mund të lexohen në www.azichem.it/disclaimer

Faqe: 3/3

SYNTECH HAG ECO prodhohet/shpërndahet nga

IF YOU WANT TO SOLVE IT
azichem

Via Giovanni Gentile, 16/A - 46044 Goito (MN), Italia
info@azichem.com Tel. +39 0376.604185 /604365 Fax +39 0376 604398